

04

# BULETINI I RIMËKËMBJES

mars 2021



**“Rimëkëmbja dhe Fondi Kosovar për  
Garanci Kreditore”**

## “Rimëkëmbja dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore”

### hyrje

Buletini i Rimëkëmbjes është publikim periodik i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP), që synon të sjellë tek publiku, me gjuhë dhe terma të thjeshtë, elementet kryesore të Ligjit të Rimëkëmbjes dhe pakos së ndihmës për pandeminë COVID-19. Qëllimi kryesor i Buletinit të Rimëkëmbjes është që në baza mujore, të shpalos dhe ofrojë informata të përgjithshme tek publiku i gjerë rreth masave të ndërmarra nga institucionet tona sa i përket rimëkëmbjes ekonomike. Këto masa janë inicuar me qëllim të mundësimit të rimëkëmbjes ekonomike në vend, pas pasojave të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Përveç se të informojë qytetarët rreth masave të rimëkëmbjes, ky buletin synon që të paraqet nivelin e zbatimit të masave krahas inkurajimit të hisedarëve drejt monitorimit të zbatimit të tyre.

Ky edicioni i buletinit shtjellon temën e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), ku përmes skemës garantuese synon të arrijë sigurimin e likuiditetit financiar. Përmes kësaj mase Qeveria e Kosovës synon që të arrijë të ndihmojë në Rimëkëmbjen Ekonomike. Buletini i Rimëkëmbjes synon që me anë të intervistave me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për temat e caktuara në përputhje me temën e buletinit të sjell pikëpamjet e institucioneve kyçe të fushës. Krahas kësaj, INDEP ka zhvilluar intervistë edhe me përfaqësuesit e FKGK (drejtorin menaxhues të FKGK z. Besnik Berisha, dhe Menaxheren e Lartë të Garancive znj. Nora Arifi) të cilët na kanë informuar rreth kësaj qështje.

Ndikimi i Pandemisë COVID-19 sikurse në vendet e tjera në botë, edhe në vendin tonë ka ndikuar negativisht në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogëla dhe atyre të mesme. Kjo pasiqë shumë ndrmarrje kanë qenë të detyruara të punojnë me kapacitete të zvogëluara ose janë mbyllur tërësisht. Si përgjigje ndaj kësaj situatë pandemike, Qeveria e Kosovës ka miratuar Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike përmes të cilit përcakton masat e nevojshme për rimëkëmbje ekonomike. Pjesë e këtyre masave është edhe sigurimi i likuiditetit financiar përmes skemës garantuese të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK).

Kjo masë ka një rol të rëndësishëm në rimëkëmbjen e ekonomisë së Kosovës.

Kjo pasiqë vetë qëllimi i masave të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike qëndron në përkrahjen e ndërmarrjeve të ndikuara nga kriza si dhe ndërmarrjet me rëndësi strategjike për ekonominë e Republikës së Kosovës. Kjo masë ka rëndësi të madhe veçmas në rritjen e likuiditetit për ndërmarrjet mikro, të mesme dhe të vogëla (NMVM-të).

Buletini i Rimëkëmbjes realizohet si pjesë e projektit “Barometri i Rimëkëmbjes – për transparencë dhe llogaridhënie” mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).

## Ligji i Rimëkëmbjes dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) është institucion i pavarur që ka karakter zhvillimor, i cili ofron garanci kreditore për NMVM-të, duke ndarë riskun kreditor me institucionet financiare për kreditë e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të). Qëllimi kryesor i FKGK-së është që të mbështes sektorin privat në Kosovë duke zgjeruar qasjen e tij në financa duke zgjeruar qasjen në financa për NMVM-të. Kështu, mundësohet krijimi i vendeve të punës, rritja e prodhimit vendor, përmirësimi i bilancit tregtar dhe rritja e mundësive për sektorët ekonomikë më pak të përkrahur.

FKGK rregullohet përmes Ligjit Nr. 05/l-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Ky ligj ka themeluar Fondin Kosovar për Garanci Kreditore si dhe përmes tij përcaktohen autorizimet, struktura, qeverisja, funksionimi, fushëveprimi si dhe politikat e procedurat për lëshimin e garancive kreditore. Ky Fond ofron garanci kreditore për Institucionet e Regjistruara Financiare për kredi të caktuara kryesisht për NMVM-të.

**Aktualisht, institucionet partnere financiare të FKGK-së janë:**

Banka Ekonomike Sh.A.,  
Banka Kombëtare Tregtare,  
Banka për Biznes Sh.A.,  
NLB Banka Sh.A.,  
ProCredit Bank Kosovo J.S.C.,  
Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.,  
TEB Sh.A.,  
Raiffeisen Leasing Kosovë



Në të ardhmen, pritet që edhe institucione të tjera financiare t'i bashkangjiten marrëveshjes me FKGK.

## 1. Çka është garancia kreditore e FKGK-së ?

Garancia kreditore e FKGK-së është garanci për të ndarë rrezikun me institucionet partnere financiare për kreditë e ndërmarrjeve mikro, të vogla, dhe të mesme. Garancinë kreditore mund ta marrin vetëm ato NMVM të cilat i plotësojnë kushtet e parapara si në vijim:

- NMVM-të të jenë në pronësi private pa asnjë pronësi të Qeverisë gjatë periudhës së mbulimit të kredisë nga garancisë;
- NMVM-të të jenë të regjistruara në ARBK dhe kanë Numër Unik Identifikues;
- Pronari i NMVM-së duhet të jetë së paku 50% të kohës banor rezident i Kosovës;
- NMVM-të të kenë më pak se 250 punonjës;
- NMVM-të të mos jenë të ndaluara nga legjislacioni i aplikueshëm, dispozitat rregullatore ose traktatet ndërkombëtare në të cilat Kosova është palë;

Përmes këtyre kushteve përcaktohen edhe mundësitë e marrjes së garancive kreditore nga FKGK.

Tabela 1. Të dhënat rreth numrit të kredive të lëshuara gjatë

Gjithsej kredi aktive	Shtator -20	Tetor -20	Nentor-20	Dhjetor -20
Shuma e miratuar e kredive	207,338,986	213,299,323	220,286,086	228,978,171
Gjithsej kredi aktive	110,515,432	105,684,530	112,057,405	110,778,122
Shuma e miratuar e garancive	100,211,029	103,200,029	106,528,479	115,006,881
Gjithsej garanci aktive	53,748,747	51,361,654	54,769,586	55,958,409
Numri i kredive	5,451	5,623	5,865	6,103 <sup>1</sup>

<sup>1</sup>Burimi:

<https://fondikgk.org/wp-content/uploads/2021/02/Zhvillimi-i-portfolios-SHQ-Dhjetor-2020.pdf>

## 2. Cilat biznese do kualifikohen për këtë masë të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike ?

Zbatimi i Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike bëhet përmes krijimit të dritareve garantuese për sektorët dhe segmente të caktuara që janë të ndikuara nga kriza ekonomike e shkaktar nga COVID-19

Këto dritare garantuese do të mbështesin qasjen në financa për NMVM-të:



Parametrat për NMVM-të që kualifikohen për financim nën garanci përfshijnë, por pa u kufizuar në:

- NMVM-të në pronësi private, pa asnjë pronësi të Qeverisë gjatë periudhës së mbulimit të kredisë nga garancioni;
- NMVM-të që kanë regjistrimin e biznesit dhe numrat fiskalë;
- Fermerët me Numër Identifikues të Farmerit dhe jo domosdoshmërisht të regjistruara në ARBK;
- Një huamarrës i kualifikuar duhet të jetë të paktën pesëdhjetë për qind (50%) në pronësi të qytetarëve privatë ose banorëve të përhershëm të Kosovës;
- NMVM-të që kanë më pak se 250 punonjës;
- NMVM-të që kanë dëshmuar historië pozitive kreditore (Klasifikimi – Standard A);
- NMVM-të që kanë pasur performancë të mirë financiare para pandemisë.

### 3. Cilat kredi mund të përfitojnë nga Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike ?

Në mënyrë që të jenë të pranueshme për përfitimet e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike duhet të i plotësojnë këto kritere:

- Shuma maksimale e kredisë është 1,000,000 EUR;
- Shuma maksimale e garancisë është 250,000 EUR – 500,000EUR\*;
- Afati maksimal i kthimit të kredisë së garantuar deri 84 muaj;
- Qëllimi i kredisë mund të jetë për investime afatgjata si dhe për kapitali punues.
- Shuma maksimale e garancisë për sektorin e prodhimit është deri në 500,000EUR

### 4. Cilat janë karakteristikat e garancisë ?

Parametrat për NMVM-të që kualifikohen për financim nën garanci përfshijnë, por pa u kufizuar në:

- Garancitë do të ofrohen për shumën deri në 80% të kryegjësë së kredisë. Rritja e përqindjes së garancisë nga 50% në 80%;
- Kufiri maksimal i humbjes do të jetë 30%;
- Tipi i garancisë: Një shfrytëzim;
- Periudha e përfshirjes: Një vite (deri 31 dhjetor 2021)

## 5. Cilat janë përfitimet nga Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike



Për NMVM-të:

- Rritje e qasjes në financa
- Potencialisht norma preferenciale të interesit
- Reduktim i kolateralit
- Kohë më e shpejtë e përpunimit të kërkesave për kredi
- Qëndrueshmëri e biznesit-mundësi e dyte

Për Institucionet Partnere Financiare:

- Ulje të rrezikut kreditor
- Ulje të kostos së rrezikut
- Lirim i kapitalit
- Rritje e portofolios kreditore

## 6. Cili është procesi i aplikimit dhe aprovimit ?

Për NMVM-të:

- Huamarrësi potencial (NMVM) nuk aplikon për garanci por aplikon për kredi në njërin nga Institucionet Partnere Financiare të FKGK-së.
- Institucioni Partner Financiar pasi që të kryen analizën e zakonshme të kredisë duke zbatuar standardet e miratimit dhe nëse kompania i plotëson kriteret e FKGK-së atëherë vet Institucioni Financiar përkatës do e vendos kredinë nën garancinë kreditore të FKGK-së.

Ndikimi i kësaj mase të ndërmarrë nga Qeveria e Kosovës për rimëkëmbjen ekonomike është vërejtur që në muajt e parë (dhjetor 2020 – janar 2021). Vetëm gjatë këtyre muajve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dallohet një rritje prej 40% të fluksit të aplikimeve për kredi. Muajt në vijim ky fluks pritet të rritet edhe më shumë duke konkluduar kështu se kjo masë është duke e dhënë kontributin e vet në rimëkëmbjen ekonomike.

Numri më i madh i aplikueve kryesisht janë ndërmarrjet mikro të cilat kanë të punësuar deri 5 punëtorë. Këto ndërmarrje përfshijnë rreth 80% të aplikimeve, për dallim prej ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të cilat kanë përqindje më të vogël të aplikueshmërisë. Kjo përqindje parashihet të mbetet e ngjashme edhe muajt në vijim, pasi që bizneset mikro janë ato të cilat prijnë më aplikimet për kredi. (box: 80% e aplikimeve janë mikro dhe të vogla)



Tabela 2. Rezultatet e aplikimeve për kredi në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes (PRE) deri më 28 shkurt 2021

Dritaret në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE)	Numër	Vlera e Kredisë	Vlera e Garancisë	Vlera mesatare e kredisë	Vlera mesatare e garancisë
Gjithsej PRE	130	6,791,650	4,964,220	52,243	38,186
Dritarja e Grave në biznes	22	792,600	626,580	37,027	28,481
Dritarja e Bujqësisë	11	254,100	168,630	23,100	15,330
Dritarja e Prodhimit	17	746,450	571,210	43,909	33,601
Dritarja e Shërbimeve	23	832,500	642,800	36,196	27,948
Dritarja e Tregtisë	57	4,166,000	2,955,000	73,088	51,842 <sup>2</sup>

Në javët dhe muajt në vijim, FKGK pritet të rrisë portfolion e vet të mbështetjes me hyrjen edhe të bankave të tjera në marrëveshje. Zgjerimi i mbështetjes nga ana e FKGK-së është ndër shtyllat kryesore të Ligjit Nr. 07/L-016 të Rimëkëmbjes Ekonomike. Efektet e kësaj mbështetje në ekonomi, pritet të shihen në muajt në vijim atëherë kur priten të lirohen miliona euro në treg dhe kur bizneset do të kenë mundësinë të realizojnë investimet e mbështetura nga kjo skemë. Deri atëherë, Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike pritet të japë rezultate të plota në mbështetjen e një ekonomie të gjunjëzuar nga pandemia COVID-19.

Për më shumë informata rreth Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, klikoni butonin më poshtë.

**KLIKO KËTU**

<sup>2</sup>Burimi:

<https://fondikgk.org/vijat-garantuese/pako-e-rimekembjes-ekonomike/>

# 04

# BULETINI I RIMËKËMBJES

mars 2021



Ky buletin është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit të Kosovës për shoqëri të Hapur (KFOS). Pikëpamjet e shprehura në këtë buletin janë INDEP dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si qëndrim i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të hapur (KFOS).